

Konferenca e Përbashkët Vjetore e Shërbimeve të Ujesjellësit dhe Kanalizimit

Prishtinë, 5-6 nëntor 2015

**KUADRI LIGJOR DHE
INSTITUCIONAL
PËR MBROJTJEN E BURIMEVE TË
UJIT TË PIJSHËM NË KOSOVË**

Afrim Lajçi

Këshilltar për Çështje Rregullatore

Këshilli Ndërmnistror i Ujërave

Zyra e Kryministrit

QËLLIMI I PREZANTIMIT

1. Të paraqitet **gjendja aktuale** e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e burimeve të ujit në Kosovë
 - Çka përmban dhe si po zbatohet?
 - Cilat janë mangësitë e këtij kuadri?
2. Të rekomandohen **përmirësimet** rregullimit ligjor dhe institucional që do të mundësonin mbrojtje efektive të burimeve të ujit
3. Të shfrytëzohet ky **forum për diskutimin** e kësaj teme që është me rëndësi qenësore për sigurinë e furnizimit me ujë

PARIMET

- Me rëndësi për **parandalimin e ndotjes** dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës.
- Realizohet përmes përcaktimit të **zonave mbrojtëse** përreth burimeve dhe përkufizimit të masave me të cilat ndalohen apo kufizohen veprimtari të caktuara.
- **Projekti i mbrojtjes së zonës** së burimit të ujit që shfrytëzohet për pije duhet të hartohet në fazën e projektimit të sistemit
- **Zbatimi kompleks** - përfshinë masa monitoruese, masa të planifikimit dhe rregullimit urban, masa inspektuese dhe administrative.

KUADRI LIGJOR

- **Ligji për Ujëra** (paragrafi 2 i nenit 66) – ‘*Ministria në bashkëpunim me IKSHP nxjerrë aktin nënligjor për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare.*’
- **UA Nr. 13/07 (2007)** – ka specifikuar masat mbrojtëse për të gjitha tipet e burimeve të ujërave nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore në tri zonat e mbrojtura: I-rë, II-të, dhe III-të. (zëvendësuar në vitin 2014 me UA nr. 28).
- **Vendimet e qeverisë** për shpalljen e zonave të mbrojtura ujore – 24 vendime për 28 burime kryesore ujore të cilat shfrytëzohen për pije
- 28 burime – 19 burime nëntokësore, 5 ujërrjedha të hapura dhe 4 akumulacione.

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

MMPH

- **Përgatitë vendimet** për caktimin e zonave të mbrojtura ujore dhe i'a propozon qeverisë për miratim (neni 38 i UA).
- **Mbikëqyrë** zonat e mbrojtura ujore dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e tyre (neni 41 i UA).
- Harton dhe mban **regjistrin e zonave** të mbrojtura (neni 41 i UA).
- Realizon **mbrojtjen e përkohshme** të burimeve ujore deri në nxjerrjen e vendimeve (neni 44 i UA).
- I trajton **ndërtimet pa leje** (kategorisë së III), legalizimin ose rrënimin e atyre që nuk mund të legalizohen në pajtim me Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (Nr. 04/L-188).
- **Harton planin** e veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse (neni 13.9 i Vendimit të Qeverisë).

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

KOMPANITË E UJËSJELLËSIT

- **Zbatimi i vendimit** për zonat e mbrojtura ujore dhe mirëmbajtja e tyre rreth burimeve ujore (neni 42 i UA). Me vendimet e Qeverisë (neni 9) kjo përgjegjësi është kufizuar në mirëmbajtjen e zonës së I-rë dhe të II-të.
- **Mbrojtja e zonës së I-rë me rrethojë** dhe vendosja e shenjave në zonën e I-rë dhe të II-të të mbrojtjes. Kjo përgjegjësi edhe pse nuk thuhet në mënyrë eksplicite, inferohet (nënkuptohe) nga neni 8 i UA.
- **Hartimi i raportit vjetor** për MMPH (neni 9 i vendimit të Qeverisë për caktimin e zonave të mbrojtura dhe masave mbrojtëse të burimeve ujore).

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

KOMUNAT

- Përfshirja e zonave të mbrojtura ujore në **hartat zonale** të komunave.
- **Trajtimi i ndërtimeve ekzistuese pa leje** në pajtim me dispozitat e ligjit – inicimin e procesit të rrënimit për ato objekte që bien në kundërshtim me vendimin e qeverisë për zonat e mbrojtura ujore.
- **Rrënimin e objekteve** që nuk mund të legalizohen.

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE TË PASPECIFIKUARA

- **Kryerja e punëve hulumtuese** dhe hartimi i projektit për mbrojtjen e burimit (neni 38, paragrafi 2 i UA)
- **Kontrolli i posaçëm i zonave të mbrojtura** në burimet ekzistuese (neni 45 i UA), që nënkupton përcjelljen e kualitetit të ujit në burim dhe në pika dhe lokalitete të rrezikuara në pellg, si dhe kontrollimin e aktiviteteve të cilat janë në kundërshtim me kriteret e UA.
- **Vendosja e sistemit të menaxhimit të mbeturinave** (neni 15 i vendimit të Qeverisë). Kjo përgjegjësi realisht është e komunave që me planin e komunal të menaxhimit të mbeturinave (në pajtim me Ligjin për Mbeturinat Nr.04/L-060).

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE TË PASPECIFIKUARA

- **Rikonstruktimi i rrugëve ekzistuese rreth akumulacioneve duke vendosur një sistem të largimit dhe pastrimit të ujërave atmosferike (në rastet kur aplikohet, p.sh në vendimin për liqenin e Badovcit).**

Në bazë të Ligjit për Rrugët (Ligji Nr. 2003/11 dhe Ligji Nr. 03/L-120), Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për autoudhët, rrugët magjistrale (nacionale) dhe rajonale, ndërkaq komunat për rrugët lokale (urbane).

- **Marrja e masave për eliminimin e keqpërdorimeve të ujit në kanale dhe ujërrjedha prej të cilave mbushen akumulacionet (në rastet kur është e aplikueshme, p.sh. në vendimin për akumulacionin e Radoniqit).**

Kjo përgjegjësi në fakt është e MMPH-së që përmes inspektorit të ujërave duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në pajtim me kompetencat e këtij të fundit të dhëna me Ligjin për Ujërat.

MANGËSITË E KUADRIT LIGJOR

Nuk janë precizuar qartë:

- Cila është **procedura** për nxjerrjen e vendimit për zonat e mbrojtura?
- Kush ka **përgjegjësi kryerjen e hulumtimeve** dhe hartimin e projektit të mbrojtjes së burimit ujor?
- Cila është **ndarja e saktë e përgjegjësive** institucionale për zbatimin e masave mbrojtëse:
 - o Çka nënkupton përgjegjësia e KRU-ve për zbatimin e vendimit?
 - o Cili është roli dhe **cilat janë përgjegjësitë e komunave**?
 - o Çka nënkupton përgjegjësia e MMPH për mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura sanitare dhe për zbatueshmërinë e masave mbrojtëse?

MANGËSITË E KUADRIT LIGJOR

- **Si veprohet me ndotësit** të cilët janë brenda zonave mbrojtëse në kundërshtim me UA;
- **Kush e kryen kontrollin teknik** të zonave mbrojtëse?
- Nuk janë dhë detaje për **vendosjen e shenjave** në zonën e I-rë dhe në zonën e II-të – forma dhe përmbajtja e këtyre shenjave.
- Për **ujërrjedha** janë përcaktuar 3 zonat sanitare, ndërkaq praktikë normale është që për këtë tip të burimeve të përcaktohet **vetëm një zonë** mbrojtëse.
- Ka mbetur **përfshirja e pakuptimtë e ujërave termale** ne UA edhe pse qëllimi i UA është mbrotja e burimeve të ujit të cilat përdoren për furnizim me ujë të pijes.

VEPRIMET E REKOMANDUARA

VEPRIMET AFATSHKURTA

- a) Identifikimi dhe mirëmbajtja e zonave mbrojtëse nga ana e KRU-ve në pajtim me vendimet e Qeverisë, si vijon:
- **Përkufizimi në terren** të zonës së I-rë dhe zonës së II-të mbrojtëse;
 - **Vendosja e rrethojës** së fortë rreth zonës së I-rë në pajtim me vendimin e Qeverisë;
 - **Vendosja e shenjave** të duhura në kufirin e zonës së I-rë dhe zonës së II-të me të cilat njoftohen kalimtarët për zonat mbrojtëse dhe paralajmërohen për ndalesën e hyrjes, respektivisht kufizimin e veprimtarive (zona e II-të);
 - **Inventarizimi i të gjitha objekteve** ekzistuese dhe veprimtarive që zhvillohen në zonën e I-rë dhe të II-të;
 - **Përgatitja e raportit** me të dhëna tekstuale dhe grafike lidhur me veprimet e ndërmarra në zonën e I-rë dhe zonën e II-të mbrojtëse.

VEPRIMET E REKOMANDUARA

AFATSHKURTA OPERATIVE

- b) Inicimi i procedurës së legalizimit** respektivisht rrënimit të objekteve ekzistuese në zonat e mbrojtura ujore konform ligjit për trajtimin e ndërtimeve ilegale.
- c) Vendosja e masave rikuperuese dhe monitorimi i gjendjes** për objektet ekzistuese që kanë leje ndërtimore e të cilat janë në kundërshtim me kriteret dhe masat mbrojtëse të përcaktuara me UA dhe vendimet e Qeverisë.

[Kostoja e këtyre veprimeve bie mbi pronarin e objektit. Nëse edhe me masat rikuperuese evidentohet ndotje e ujit, MMPH do të iniciojë procedurën e rrënimit.]

VEPRIMET E REKOMANDUARA AFATSHKURTA ADMINISTRATIVE

- **Përgatitja e propozimeve nga MMPH** e vendimeve për caktimin e zonave të mbrojtura për burimet e mbetura të ujit të pijshëm për të cilat nuk janë lëshuar vendime nga Qeveria;
- **Nxjerrja e vendimeve nga Qeveria** sipas propozimit të MMPH-së për burimet që nuk kanë ende vendim;
- **Rishikimi dhe amendimi i UA Nr. 28** me qëllim të adresimit të mangësive të identifikuara të këtij UA në veçanti sa i takon saktësimin të roleve dhe përgjegjësive institucionale;
- **Përfshirja e zonave të mbrojtura ujore në sistemin informativ ujor dhe në hartën zonale të Kosovës nga MMPH dhe në hartat zonale të komunave respektive.**

VEPRIMET E REKOMANDUARA

AFATMESME

- **Kryerja e punimeve hulumtuese dhe hartimi i projekteve (elaborateve) për mbrojtjen e burimeve ujore për secilin burim ujor që shfrytëzohet për furnizim publik me ujë.**

[Kjo punë duhet të kryhet nga pronari i sistemit që shfrytëzon burimin – KRU përkatëse.]
- **Nxjerrja e vendimeve të reja nga Qeveria me propozim të MMPH-së duke u bazuar në punimet hulumtuese dhe projektet e mbrojtjes së burimeve të përpiluara dhe dërguara nga KRU-të.**
- **Ndërmarrja e masave të rregullta mbikëqyrëse dhe mbrojtëse në të gjitha zonat e mbrojtjes për të gjitha burimet e ujit që shfrytëzohen për furnizim publik me ujë.**

KONKLUSIONE

- **Kosova e ka normativizuar mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm me ligj, akte nënligjore dhe vendime të qeverisë.**
- **Nxjerrja e akteve normative nuk ka rezultuar me veprime konkrete praktike në pajtim me këto akte;**
- **Mungesa e veprimeve – rezultat i:**
 - **Kostove e konsiderueshme** që lidhen me zbatimin e këtyre masave
 - **Mungesës së qartësisë** sa i takon përgjegjësive institucionale.
- **Veprimet e rekomanduara:**
 - **përkufizimi dhe shenjëzimi** i zonës së I-rë dhe të II-të si dhe **inventarizimi i objekteve** brenda këtyre zonave.
 - **amendimi i UA** me qëllim të adresimit të magësive që ka UA aktual, dhe
 - **kryerja e punimeve hidro-gjellogjike dhe hartimi i projekteve për mbrojtjen e burimeve** ujore nga ana e KRU-ve dhe zbatimi i këtyre projekteve.

Ju faleminderit për vëmendjen!